

VENDIM
Nr. 16, datë 30.1.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE ME SERI PV10K, NR. 112, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 110, DATË 22.12.2010 PËR SHOQËRINË “ENERGY PLUS” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germat “a” dhe “b” të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 112, seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 22.12.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore, siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15 pika 4 germa “a”: informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15 pika 4 germa “b”: vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 112, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Pobreg” me fuqi 9 Mw, të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 22.12.2010.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani